



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 52

Tiranë – E enjte, 16 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.3.2017	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit.....	3247
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 208, datë 15.3.2017	Për krijimin e Muzeut Kombëtar “Gjethi”	3279
Urdhër i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 53, datë 13.3.2017	Për delegimin e kompetencave.....	3279

**VENDIM**

Nr. 187, datë 8.3.2017

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRIN, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

1/1. Kryeministria, aparatet e ministrive të linjës, administrata e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoritetit të Konkurrencës, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Entit Rregullator të Energjisë, Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoriteti i Mediave Audiovizive, administrata e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Instituti për Krimet dhe

Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi, administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, administrata e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit, Gjykata e Lartë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

1/2. Institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore në varësi të Kryeministrit, ku bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik, Instituti i Statistikës, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Instituti i Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, administrata e Akademisë së Shkencave, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, Inspektorati Qendror, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, Agjencia e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog, Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Shkodër, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Tiranë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Korçë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Vlorë, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER), Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, Komiteti Shtetëror i Kulteve dhe administrata e Shkollës së Magjistraturës.

1/3. Institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore në varësi të ministrave të linjës, të cilët në kuptimin e këtij vendimi kategorizohen, si më poshtë:

a) Institucionet qendrore të grupit të parë, ku bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale,



Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia e Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, nëpunësit civilë në pozicionet mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, punonjësit civilë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtorinë e Shifrës, në Komandën dhe Shtabin e Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Avokatura e Shtetit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Qendra Kombëtare e Biznesit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë.

b) Institucionet qendrore të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë: Administrata e Prefektit, Instituti i Studimeve të Transportit, Arkivi Qendror Teknik

i Ndërtimit, Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Komiteti Olimpik Shqiptar, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Kombëtar “Gjethi”, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Drejtoria e Akreditimit, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, administrata e universiteteve, shkollave të tjera të larta dhe punonjësit civilë jomësiorë në Universitetin Ushtarak dhe Akademinë e Mbrojtjes, Shërbimi i Provës, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, Teatri Kombëtar i Komedisë, Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, punonjësit civilë në Komandën dhe Shtabin e Forcës Tokësore, Komandën dhe Shtabin e Forcës Detare, Komandën dhe Shtabin e Forcës Ajrore, Komandën dhe Shtabin e Komandës Mbështetëse, Qendrën e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Qendrën e Personel Rekrutimit, Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes, punonjësit civilë jomësiorë në Akademinë e Forcave të Armatosura, Akademinë e Nënoficerëve, Shkollën e Trupës dhe Qendrën e Stërviçjes Individuale në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes, Qendrën e Riparimit



dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës, Çirku Kombëtar, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar për Rininë, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Inspektorati Shtetëror i Ujërave.

c) Institucionet qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë: Inspektorati Hekurudhor Durrës, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit Sarandë, Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, Agjencia e Shërbimeve të Sportit Tiranë, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti”, Krujë, Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë, Klubi Shumësportësh “Partizani”, Federatat e Sportit, Qendra Pritëse e Azilkërkuesve Babrru, Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme Durrës, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, Sektori i helikopterëve të Repartit Special Rënea dhe punonjësit civilë në Muzeun e Forcave të Armatosura, Shtëpitë e Pushimit të sistemit në Ministrinë së Mbrojtjes, Qendrën e Bashkuar Operacionale të Forcave të Armatosura, Qendrën e Menaxhimit të Materialeve, Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, Policinë Ushtarake, Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Batalion/kompani/qendra stërvitore në Forcën Tokësore, Flotiljen Detare/Shërbimin Hidrografik/Qendrën e Vëzhgimit Detar/Qendrën e Zhytjeve/Qendrën Stërvitore/Kompani në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimin Meteorologjik Ushtarak/

Qendrën e Kontroll Raportimit/Qendrën Stërvitore/Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/Kompani/Qendrën Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/Qendra në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

2. Struktura dhe vlerat e pagave sipas kategorive për nëpunësit civilë dhe nëpunësit në të gjitha institucionet e cituara në pikën 1 më sipër, të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementët e pagës janë si vijon:

a) Paga e grupit, kolona 2, e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3), e lidhjes nr. 1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

c) Shtesa për kualifikim (kolona 4), për nëpunësit në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Anëtar i Organeve Kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura, të përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi”, “Drejtor departamenti”, “Drejtor i përgjithshëm”, “Drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës, të kategorizuara në kategorinë II-b ose më të lartë, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi”, “Titullar dhe zëvendëstitullar i institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës”, “Prefekt”, “Nënprefekt”, si dhe funksionarët politikë “Zëvendësministër” e anëtarë të kabineteve, përfitojnë shtesën për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

- Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas



rasti, nga Departamenti i Administratës Publike, për Kryeministrinë, aparatet e ministrive të linjës, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të Kryeministrit, institucionet qendrore/rajonale vendore në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit, si dhe nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor që ka.

Në çdo rast, si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli shkencor që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë që ka.

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të kësaj pike.

Shtesa për kualifikim (kolona 4) e lidhjes nr. 1, për të gjitha pozicionet e tjera të jetë 0.

ç) Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr. 1.

Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, të përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së secilit institucion.

3. Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura, të jetë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/1. Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës, për funksionet e veçanta në Kryeministri, të jetë sipas lidhjes nr. 3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/2. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Departamentin e Administratës Publike, të jenë sipas lidhjes nr. 3/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/3. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Shkollën e Magjistraturës të jenë sipas lidhjes nr. 3/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, e konkretisht:

4/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët e drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional/Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike”, “Inxhinieri matematike informatike” apo “Shkenca kompjuterike”, në masën:

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të cilët punojnë me bazat e të dhënave shtetërore, në institucionet e përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij vendimi.

Aplikimi i kësaj shtese bëhet vetëm në rastet kur institucionet kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore, të miratuara e të regjistruara pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve të përcaktuara në pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, të këtij vendimi, të cilët nuk punojnë me bazat e të dhënave shtetërore.

- 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve rajonale/vendore.

Zbatimi i shtesave, si më sipër, për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Përjashtohen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të vërë në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave listën e përditësuar të



institucioneve që kanë krijuar baza të të dhënave shtetërore dhe janë regjistruar si të tilla pranë këtij institucioni, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se, për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhin ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat.

4/2. Në Kryeministri, pozicionet, “Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj”, dhe “Drejtor i Departamentit të Jetësimit të Prioriteteve”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj; pozicionet “Drejtor njësie, jurist, koordinator dhe inspektor në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit”, “Drejtor njësie, Drejtor drejtorie, jurist dhe koordinator në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj” dhe pozicionet “Koordinator në Departamentin e Jetësimit të Prioriteteve”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/3. Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nëpunësit në pozicionet “Inspektor i lartë” dhe “Ndihmësinpektor i lartë”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/4. Në Komisionin e Prokurimit Publik, kryetari i komisionit në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa zëvendëskryetari, anëtarët dhe nëpunësit në drejtoritë apo sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/5. Në Agjencinë e Prokurimit Publik, nëpunësit në pozicionet “Titullar institucioni”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë dhe sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/6. Në Agjencinë e Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private, nëpunësit në pozicionin “Titullar i institucionit”, në masën 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa nëpunësit në pozicionet “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në drejtoritë dhe sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4/7. Punonjësit e degëve të thesarit që punojnë në sistemin AMoFIS, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për

pozicionin përgjegjës i degës së thesarit Tiranë; 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj për punonjësit e tjerë të degës së thesarit Tiranë dhe 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj për degët e tjera të thesarit.

4/8. Në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nëpunësit në pozicionet “Titullar i institucionit” dhe “Administrator”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/9. Në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë, Cirkun Kombëtar, punonjësit e trupës artistike në këto institucione, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

4/10. Në Drejtorinë e Shifrës, nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/11. Në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, nëpunësi në pozicionin “Titullar i institucionit”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Inspektor”, në sektorët teknikë, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4/12. Në Ministrinë e Financave, nëpunësit civilë në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtor i Përgjithshëm”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, si dhe funksionarët në pozicionet “Drejtor i kabinetit të ministrit”, “Zëdhënës” dhe “Këshilltar”, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4/13. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, nëpunësit civilë në pozicionet “Drejtor i Përgjithshëm”, “Drejtor Drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4/14. Në Institutin e Statistikave, nëpunësit civilë në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/15. Në Departamentin e Administratës Publike, nëpunësit civilë në pozicionet “Drejtor Departamenti”, “Drejtor Drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4/16. Në Kryeministri, nëpunësit civilë dhe funksionarët në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtor i Departamentit të



Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit”, dhe “Drejtor i Kabinetit të Kryeministrit”, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë.

5. Përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin nëpunësit në pozicionet:

- “Përgjegjës i sektorit të arkivit” dhe “Specialist arkivi”, në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, si dhe në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit;

- “Përgjegjës sektori” dhe “Laborant” në laboratorët e naftës e të gazit dhe laboratorët e lëkurë-tekstileve, si dhe “Inspektor” të naftës dhe gazit në Doganë, autobot, cisternë dhe depozitë tokësore, në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial;

- “Nëpunësit” në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, në Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe në Laboratorin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- “Stenograf, regjistruues audio”, në Kryeministri.

- Nëpunësit në njësitë e përmbajtjes së Bibliotekës Kombëtare, përjashtuar titullarin dhe zëvendëstitullarin e institucionit. Njësitë e përmbajtjes së institucionit përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së Bibliotekës Kombëtare.

Kjo shtesë aplikohet në masën dhe sipas rregullave e kriterëve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

6. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësimin, prefektin, nënprefektin, nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës dhe prefekturë janë, si vijon:

- Zëvendësministër 153 300 lekë;

- Drejtor i Kabinetit të Presidentit, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, të Prokurorit të Përgjithshëm, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a.

- Zëvendës drejtor i Kabinetit të Kryeministrit 154 900 lekë.

- Kryendihmës në kabinetin e Kryeministrit 152 200 lekë.

- Këshilltari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshilltari për Protokollin i Kryeministrit, Këshilltari për Protokollin i Presidentit, zëdhënësi i Presidentit, Drejtori i Kabinetit të zëvendëskryeministrit, Drejtori i Kabinetit të Avokatit të Popullit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Avokatit të Popullit, Ndihmësi i Presidentit, i Kryeministrit dhe i Kryetarit të Kuvendit dhe Këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b.

- Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit dhe i nënkryetarit të Kuvendit, Drejtori i Kabinetit të ministrit dhe drejtorët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.

- Këshilltari i ministrit, zëdhënësi i ministrit dhe këshilltarët dhe zëdhënësi i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 më sipër, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.

- Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.

- Prefekti i Qarkut të Tiranës 130 300 lekë.

- Prefekti i qarqeve të tjera 118 300 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë 99 800 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 92.400 lekë.

- Nënprefekti i nënprefekturave Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 88 000 lekë.

- Këshilltari i Prefektit të Qarkut të Tiranës 69 800 lekë.

- Zëdhënësi i Prefektit të Qarkut të Tiranës 59 300 lekë.

- Sekretari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Gjykatës së



Lartë, i Prokurorit të Përgjithshëm, i Zëvendës-kryeministrit, i Nënkryetarit të Kuvendit dhe i Avokatit të Popullit 73 500 lekë.

- Sekretari i ministrit, sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit, sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të sekretari i organit kolegjial drejtues, sekretar në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi 61 950 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për të gjitha pozicionet “Sekretar”, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë për femrat dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga Kryeministri.

Të drejtën për të pasur ndihmës të jashtëm e ka vetëm Kryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës së kategorisë I-b. Masa e pagesës përcaktohet nga Kryeministri.

Titullari i Agjencisë së Trajtimit të Pronës ka të drejtë të ketë një këshilltar të jashtëm. Pagesa e tij mujore është sipas kategorisë III-a.

7. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve, në administratën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit dhe administratën e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit, janë sipas lidhjes nr. 4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në

“Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/2, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/1. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, janë sipas lidhjes nr. 5/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/2. Nivelet e pagave për punonjësit efektivë kërkimorë e shkencorë në Akademinë e Shkencave, janë sipas lidhjes nr. 5/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Inspektoratin Qendror dhe në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, janë sipas lidhjes nr. 5/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, janë sipas lidhjes nr. 5/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/a, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), të cilët sipas organizimit të mëparshëm kanë pasur emërtesën “Koordinator” dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.

9/1. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, janë sipas lidhjes nr. 6/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



9/2. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, janë sipas lidhjes nr. 6/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Agjencinë e Trajtimit të Pronës, të jenë sipas lidhjes nr. 6/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, janë sipas lidhjes nr. 6/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/5. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, janë sipas lidhjes nr. 6/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, të përcaktuar në pikën 1/3/a, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 6/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/7. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor, janë sipas lidhjes nr. 6/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit/punonjësit e kategorizuar në kategoritë C3, D1, D2, dhe D3, të lidhjes nr. 6/7, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë, në masën 1% mbi pagën e pozicionit pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.

9/8. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit tatimor, janë sipas lidhjes nr. 6/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/9. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve në Avokaturën e Shtetit janë sipas lidhjes nr. 6/9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Avokaturës së Shtetit, të cilët deri në datën 10 shkurt 2012, përfitonin një pagë më të lartë sesa parashikohet në lidhjen nr. 6/9, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën e mëparshme. Nëpunësit e tjerë përfitojnë pagat sipas përcaktimit në lidhjen nr. 6/9.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit, në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.

9/10. Kategoritë e pagave dhe shtesa për natyrë të veçantë pune dhe vështirësi shërbimi të pozicioneve civile të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të jenë sipas lidhjes nr. 6/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pozicionet në funksione operacionale, operacionale mbështetëse dhe mbështetës, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së kësaj agjencie.

10. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/b, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 7/1 (pjesa I dhe II), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit që paguhen sipas lidhjes nr. 7/1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë.



10/2. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë sipas lidhjes nr. 7/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/3. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, janë sipas lidhjes nr. 7/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit që paguhen sipas lidhjes nr. 7/3, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.

10/4. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që përcaktohen në pikën 1/3/b, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 7/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/5. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Sekretar i Përgjithshëm”, në administratën e Prefektit, janë sipas lidhjes nr. 7/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet e përcaktuara sipas pikës 1/3/c, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që përcaktohen në pikën 1/3/c, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 8/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/2. Vlera e pagës për pozicionet e punës dhe shtesa për kushte pune në sektorin e helikopterëve të Repartit Special Renea, janë sipas lidhjes nr. 8/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit që paguhen sipas lidhjes nr. 8/2, jepet në masën 2% pas çdo

viti pune deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.

12. Kategoritë e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në institucionet rajonale/vendore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, ministrave të linjës, në institucionet rajonale/vendore, në varësi të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, në institucionet vendore në varësi të institucioneve rajonale, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të bordeve të kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura, të jenë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Inspektorët veterinarë kufitarë, inspektorët fitosanitarë kufitarë dhe inspektorët e shërbimit të Inspektoratit Ushqimor, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, të cilët bëjnë pjesë në grupet e kontrollit doganor, të paguhen me kategorinë IV-a.

12/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/2. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në drejtoritë e burgjeve dhe institucionet e riedukimit në rrethe, janë sipas lidhjes nr. 9/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në zyrat (drejtoritë) rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit



dhe Integrimin të Zonave/Ndërtimeve Informale, janë sipas lidhjes nr. 9/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/4. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në komisionet vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut, janë sipas lidhjes nr. 9/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12/5. Kategoritë e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, komisariate dhe reparte autonome, janë sipas lidhjes nr. 9/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Funkionarët politikë, nëpunësit e kabineteve dhe nëpunësit civilë/nëpunësit që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

14. Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të përfshira në fushën e veprimit të këtij vendimi, përcaktohen në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

15. Vendimi nr. 545, datë 11.8.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive

të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 455, datë 8.7.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, i ndryshuar, shfuqizohen.

16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2017:

- Për rritjet e vlerave të pagave për institucionet pjesë të fushës së veprimit, si dhe të aplikimit të shtesës për natyrë të veçantë pune, për Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Departamentin e Administratës Publike dhe Institutin e Statistikave, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikën e reja të pagave.

- Për të gjitha ndryshimet e ndodhura në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, përfshirë edhe ato të politikave të pagave, të përballohen nga fondet e miratuara për vitin 2017, për këtë sistem.

- Për të gjitha ndryshimet e tjera në këtë vendim, të përballohen nga fondet e miratuara për vitin 2017, për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LIDHJA NR. 1
STRUKTURA E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË/NËPUNËSIT NË TË GJITHA
INSTITUCIONET PJESE E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE			SHITESA E POZICIONIT
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a		2%		141.900
	I-b		2%		129.800
II	II-a		2%		118.100
	II-b		2%		100.000
III	III-a		2%	0	80.800
	III-a/1		2%	0	70.500
	III-b		2%	0	61.000
